



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense



RAPORTI VJETOR 2022

Prishtinë, 2022



PUBLIKUES:

Zyra për Marrëdhënie me Publikun &
Departamenti për Planifikim dhe Vlersim

PËRMBAJTJA

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË MINISTRIT TË MBROJTJES	4
INSPEKTORATI I FSK-së.....	4
AUDITIMI I BRENDSHËM	6
ZYRA PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN	7
PROTOKOLLI MINISTRISË SË MBROJTJES	8
DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTEVE DHE ARKIVIT	9
DEPARTAMENTI I PROKURIMIT	10
DEPARTAMENTI LIGJOR	11
TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZIA GJINORE.....	12
NJËSIA PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE.....	13
DEPARTAMENTI PËR POLITIKA DHE STRATEGJI (DPS)	14
DEPARTAMENTI PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR	16
REALIZOHEN ME SUKSES AKTIVITETET E PARAPARA NË PLANIN VJETOR TË VEPRIMIT PËR MM	18
DEPARTAMENTI PËR TRANSFORMIM, MODERNIZIM DHE STANDARDIZIM	19
DEPARTAMENTI PËR POLITIKAT E PERSONELIT DHE REKRUTIMIT.....	20
DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E KARRIERËS DHE VERIFIKIMIT	22
DEPARTAMENTI PËR LOGJISTIKË DHE INFRASTRUKTURË.....	23
DEPARTAMENTI PËR KOMUNIKIM DHE TEKNOLOGJI INFORMATIVE.....	25
KAPACITETET MJEKËSORE NË FSK AVNACOHEN NË BASHKËPUNIM TË NGUSHTË ME INSTITUCIONET VENDORE.....	27
DEPARTAMENTI I MBËSHTETJES	28
DEPARTAMENTI I GRUMBULLIMIT DHE ANALIZËS (DGA)	28
DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE SIGURI (DPSIG)	28
DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE	29

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË MINISTRI TË MBROJTJES

2021-2025

- Fuqizimi i mbikëqyrjes demokratike civile dhe rritja e llogaridhënies dhe transparencës.
- Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake në funksion të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial.
- Zgjerimi i bashkëpunimit bilateral, anëtarësimi në organizata dhe pjesëmarrja ne operacione ndërkombëtare.
- Mbajtja e kapaciteteve thelbësore në funksion të mbështetjes ushtarake autoriteteve civile.



INSPEKTORATI I FSK-së

Bazuar në pas planin e punës për vitin 2022, janë hartuar dhe miratuar Plani i Inspektoratit të FSK-së për vitin 2022 duke u bazuar edhe në Objektivat Strategjike të Ministrit të Mbrojtjes dhe Udhëzimet Planifikuese të KOMFSK, Planet mujore të punës për vitin 2022, Raportet tre mujore për MM dhe QRK sipas kërkesave për (TM1, TM2, TM3 dhe TM4 dhe janë dorëzuar sipas afateve kohore si dhe raporti vjetor i punës së Inspektoratit të FSK-së, për vitin 2022.



Është zhvilluar inspektim pa paralajmërim në kuzhinat e FSK-së; janë zhvilluar dy inspektime për të vlerësuar zbatueshmërinë e rekomandimeve të dhëna nga Inspektori Gjeneral i FSK-së dhe vendimeve të Ministrit të Mbrojtjes; është bërë vlerësimi mbi zbatimin e rekomandimeve të përgjithshme dhe mbi zbatimin e rekomandimeve të raporteve të Klasifikuara; Është përfunduar dhe dorëzuar raporti i furnizimit me gjenerator për kontejner; Me vendim të Ministrit është përfunduar dhe dorëzuar raporti i ATK-së dhe raporti i shërbimit të ushqimit në kuzhinat e FSK-së; Janë zhvilluar takime me Administratën Tatimore të Kosovës, NALT-in, KFOR-in dhe CIDS-in; Ka filluar Inspektimi lidhur me gatishmërinë operationale dhe është duke vazhduar në SHPFISK me njësi, ka vazhduar monitorimi i listës së kontratave për qëllime të mbrojtjes dhe sigurisë dhe aktivitetet tjera të planifikuara.

AUDITIMI I BRENDSHËM

NJAB në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-021 Për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut ka zbatuar planin vjetor të punës për vitin 2022, me të cilin janë përcaktuar entitetet tek të cilat duhet të bëhen auditimet e brendshme, lëndët të cilat duhet rishikuar, prioritetet dhe koha e nevojshme për kryerjen e tyre.

Gjatë periudhës Janar-dhjetor 2022 Njësia e Auditimit të brendshëm ka kryer njëmbëdhjetë (11) auditime të pajtueshmërisë prej të cilave nëntë (9) kanë qenë në bazë të planit të punës dhe tri auditime kanë qenë me kërkesë. Gjatë këtyre auditimeve NjAB ka dhënë 41 rekomandime, që kanë për qëllim të ofrojnë një siguri të pavarur dhe objektive menaxhmentit të MM-së për përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Zhvillimi i auditimeve të brendshme është në pajtim me rregullat, politikat, doracakët, udhëzimet, statutin e auditimit të brendshëm, sipas Ligjit të kontrollit të financave publik.



ZYRA PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN



Zyra për Marrëdhënie me Publikun gjatë periudhës raportuese një vjeçare, ka qenë e angazhuar për pasqyrimin medial të këtyre aktiviteteve, si: konferenca për media - 8, postime në rrjete sociale - 397, komunikata për media - 155, ftesa për media - 15, leje për paraqitje në media - 17, TV dhe radio-spote në dy gjuhët zyrtare - 4, deklarime për media, radio dhe televizione - 19, përgjigje me shkrim në pyetje të mediave - 104, qasje në dokumente publike - 28, publikime të Buletinit informativ (Newsletter) – version elektronik në gjuhën angleze - 12. Gjithashtu, janë realizuar aktivitetet ditore të vazhdueshme si:

monitorime, analiza, furnizim me materiale i ueb-faqes dhe në rrjetet sociale (Facebook), raportime të aktiviteteve dhe shoqërime të liderëve dhe stafit të lartë në aktivitete protokollare, si dhe mirëmbajtja dhe menaxhimi i ueb-faqes së MM-së nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Departamenti i Komunikimit të Teknologjisë Informatike të MM-së.

FSK VLERËSOHET INSTITUCIONI MË I BESUESHËM I SIGURISË NË VEND PËR TË 11-TËN HERË MË RADHË

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka konfirmuar se Forca e Sigurisë së Kosovës edhe këtë vit doli të jetë institucioni më i besueshëm i sigurisë në vend për qytetarët e Kosovës, me nivel edhe më të lartë se viteve tjera, me 83 për qind të besueshmërisë qytetare.

Ky rezultat është pasqyrim i zbatimit të duhur të objektivave me përkushtim të lartë, udhëhequr nga parimi i transparencës dhe llogaridhënies të plotë të Ministrisë së Mbrotjtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.



PROTOKOLLI I MINISTRISË SË MBROJTJES

Njësia e Protokollit gjatë këtij viti ka realizuar aktivitetet kryesore të planifikuara, aktivitetet tjera sipas kërkesave në organizimin e pritjeve për autoritetet ndërkombëtare në vizitat e tyre në MM-në dhe FSK-në, si dhe në harmonizimin dhe koordinimin e vizitave në MM dhe SHPFSK.

Disa nga aktivitetet kryesore të organizuara nga Njësia e Protokollit për këtë vij janë:

Parada për nder të ditës së Pavarësisë-17 Shkurt, Epopeja e UÇK-së 5,6, dhe 7 Mars, Togu Ceremonial dhe bendi në ditën e Çlirimit me datë 12.Qershor, etj.

Në vitin 2022 janë realizuar 36 ceremoni pritjeje ushtarake dhe aktivitetet tjera në përkrahje të vazhdueshme të protokollit të Shtetit për pritjen e autoriteteve të larta ndërkombëtare me rastin e vizitave të tyre në Kosove si dhe është bërë organizimi i 59 pritjeve për autoritetet ndërkombëtare të cilët kanë vizituar MM-në dhe FSK-në.



DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E DOKUMENTEVE DHE ARKIVIT

Sektori për Administrimin e Dokumenteve, në librin kryesor të protokollit ka proceduar 3831 dokumente dhe 3450 dokumente të digjitalizuar.

Libri i protokollit në hyrje ka proceduar 3428 dokumente. Zyra për Menaxhimin e Informacionit të Klasifikuar në Librin e Protokollit të Informatave të Klasifikuar ka proceduar 778 dokumente.



Janë përkthyer: 50 përkthime simultane; 450 dokumente të përkthyer; gjithsejtë 1986 faqe të përkthyer.

Janë lekturuar 285 dokumente të Ministrisë me gjithsej 1016 faqe. Procesit të lekturës i janë nënshtruar vetëm dokumentet të cilat janë vlerësuar si të rëndësishme nga drejtuesit e ministrisë. Dokumentet e lekturuar janë kryesisht projektligje udhëzime administrative, projekt-rregullore, strategji, doktrina, direktiva, udhëzues, memorandume, plane të veprimit, dokumente që pasqyrojnë politikat dhe konceptet e MM/FSK-së.

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Që nga fillimi i vitit fiskal 01.01.2022 deri me 20.12.2022, janë pranuar gjithsej 142 kërkesa për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të madhe, mesme, vogël, dhe minimale.

Departamenti i Prokurimit dhe Kontratave ka realizuar aktivitetet /procedurat e prokurimit si më poshtë:

Kontrata të nënshkruar sipas vlerave:


1.1 Kontrata me vlerë të madhe janë nënshkruar (22);

1.2 Kontrata me vlerë të mesme janë nënshkruar (48);

1.3 Kontrata me vlerë të vogël janë nënshkruar (08);

1.4 Kontrata me vlerë minimal janë nënshkruar (17);

Gjithsej kontrata të nënshkruara janë 95.



Në proces të tenderimit në përputhje me kërkesat dhe planin e prokurimit për vitin fiskal 2022, janë filluar procedurat e prokurimit për 18 aktivitet të prokurimit në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Në proces të shqyrtimit në AK apo OSHP, janë 2 projekte, bazuar në kërkesat për rishqyrtim dhe ankesat e Operatoreve Ekonomik janë në shqyrtim sipas të Ligjit për Prokurimin Publik. Bazuar në udhëzimin e AQP janë dërguar 4 projekte për të zhvilluar procedurat e centralizuara të prokurimit. Gjatë vitit fiskal nga data 01.01.2022 deri me datë 19.12.2022, janë nxjerrë 542 urdhër blerje në vlerë totale 99,541,039 €.

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor sipas Planit të Punës, Programit Legjislativ të Qeverisë, Planit legjislativ të akteve ligjore dhe nënligjore të MM-së, në vitin 2022, ka realizuar këto aktivitete.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuara 45 lëndë gjyqësore. Për të gjitha lëndët, Departamenti Ligjor në bashkëpunim me njësitë tjera organizative të MM-së i ka ofruar Avokaturës Shtetërore si autoritet kompetent për përfaqësim gjyqësor, të gjitha faktet dhe pretendimet në favor të institucionit, përkitazi me lëndët gjyqësore, respektivisht kundër pretendimeve të palëve paditëse.

Këto lëndë shumica prej tyre janë në proces e sipër nga Gjykatat kompetente, dhe për të njëjtat përfaqësohemi nga Avokatura Shtetërore e për disa nga këto ka përfunduar procedura.

Departamenti Ligjor sipas Planit të Punës, Programit Legjislativ të Qeverisë, Planit legjislativ të akteve ligjore dhe nënligjore të MM-së, në vitin 2022, ka realizuar 9 akte ligjore.

Gjatë vitit 2022 janë hartuar dhe miratuar 8 akte nënligjore.



TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZIA GJINORE

Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ka infrastrukturë ligjore e cila garanton Procedurat e hapura, transparente dhe inkurajuese gjatë rekrutimit dhe avancimit; Kushte të barabarta të punës; Pagesë të njëjtë për punën dhe gradën e njëjtë; Ngritje në pozitë/grada në bazë të meritës dhe mundësi të njëjta për të aplikuar në pozita të ndryshme të punës.

Aktivitetet që ka realizuar NJDNJ gjatë vitit 2022 janë:



Dorëzimi i analizës (e cila pasqyron gratë në pozita vendimmarrëse në MM) me rekomandime, në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore. Shënimi i 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në Ministrinë e Mbrojtjes me organizim të konferencës “Gratë Paqja dhe Siguria”. NJDNJ ka mbajtur ligjëratë për kadetët e Qendrës për Studime Universitare (QSU), me temën “Barazia Gjinore dhe Mbrojtja nga Diskriminimi, Ngacmimi”. Janë mbajtur shtatë (7) takime me Komandantët e Regjimenteve dhe Njësi të Komandës së Forcave Tokësore. NJDNJ, ka monitoruar: Procesin e Rekrutimit të ushtarëve aktiv në FSK; Rekrutimi i kadetëve në FSK; Bordet për Shqyrtimin e Ankesave, Bordin për Trajtime Bilaterale, Bordet për Emërime dhe Gradime. Në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, është mbajtur prezantimi me temën “Të Drejtat e Njeriut në Forcat e Armatosura – Roli i Institucionit të Avokatit të Popullit”.

NJËSIA PËR ÇËSHTJE TË KOMUNITETEVE

Njësia Për Çështje Të Komuniteteve punon në implementimin e Strategjisë për Integrimin e komuniteteve jo-shumicë në bazë Planit të Veprimit si dokument orientues i cili ofron kahje strategjike për integrim të qëndrueshëm të komuniteteve jo-shumicë në MM.

Aktivitetet e realizuara nga NJÇK:

NJÇK se bashku me NALT, ka vizituar pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Regjimentin e parë të Këmbësores (R1K) në Gjilan dhe R1K në Mitrovicë, gjatë vijimit të kursit të gjuhës shqipe. Mbështetja e përgatitjes për organizimin e „Ditës së ashkalive”, Ditës së Komunitetit Turk”, “Ditës së komunitetit boshnjak” si dhe pjesëmarrja në prezantimin e platformës "Rritja e kontrollit të brendshëm dhe transparencës buxhetore”.

NJÇK gjithashtu ka marrë pjesë në borde të rekrutimit, gradimeve dhe emërimeve, trajnime bilaterale, shqyrtimit të ankesave dhe monitorimin e tyre, komisione, punëtori, seminare, etj.

NJÇK me qëllim të realizimit të kampanjës së informimit për rekrutimin e të rinjve për rekrutë dhe kadetë në QSU, AU Maqedoni e Veriut, AU Kroaci dhe AU Turqi për komunitetet jo shumicë ka vizituar pjesën më të madhe të komunave.



DEPARTAMENTI PËR POLITIKA DHE STRATEGJI

Gjatë kësaj periudhe Plani Afatmesëm, Udhëzimet e KOMFSK-së për SHPFISK-në, Plani i Punës së MM-së për 2022, janë hartuar duke u bazuar në Strategjinë e mbrojtjes.

Është plotësuar Korniza Monitoruese për Zbatimin e Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.

Është bërë rishikimi i Qëllimeve Strategjike dhe Objektivave Operacionale të Ministrit të Mbrojtjes për vitet 2023-2025.

Pjesëmarrja në të gjitha grupet punuese në MM dhe ato ndërministrare për hartimin e 8 dokumenteve dhe projekt dokumenteve.



Punime hulumtuese, analiza me rekomandime për MM/FSK-në:

Gjatë vitit 2022 janë hartuar rreth 26 punime dhe hulumtime ku ne mesin e tyre janë punimi lidhur me garën në armatim në mes Serbisë dhe Kroacisë, arsyet dhe ndikimi në rajon, buxheti i mbrojtjes i ndarë për blerje të armëve; analiza për buxhetet ushtarake të vendeve të Ballkanit (2022) si dhe planet e Serbisë për blerje ushtarake gjatë vitit 2022, hulumtimi me temën “ Impaktet që identifikojnë prioritet e investimeve për mbrojtje”, punimi dhe analiza për Izraelin - informacione të përgjithshme dhe mundësitë e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, etj.

BASHKËPUNIMI CIVILO - USHTARAK

Në vitin 2022 është bërë koordinimi i realizimit të ligjëratave nga Instruktorët e Deminimit të FSK-së, me temën **“Vetëdijesimi i rrezikut nga mjetet e pa shpërthyerë”** (MINAT). Në 41 shkolla është mbajtur ligjërata **“Vetëdijesimi i rrezikut nga mjetet piroteknike”**.

Gjithashtu është bërë koordinimi me SHPPFSK i kërkesave për vizita nga institucionet e Republikës së Kosovës në kazermat e FSK-së, i kërkesave për mbështetje dhe koordinimi me organizatat e dala nga lufta për pjesëmarrje të Togut Ceremonial.



Koordinimi i procesit të hartimit dhe nënshkrimit të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit

Gjatë këtij viti janë hartuar dhe nënshkruar nëntë (9) memorandume mirëkuptimi dhe marrëveshje bashkëpunimi. Gjithashtu janë në proces janë pesë draft-marrëveshje bashkëpunimi.

DEPARTAMENTI PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi bilateral

- Në vitin 2022 ka vazhduar bashkëpunimi bilateral me partnerin tonë strategjik, SHBA si dhe partneriteti me Gardën Kombëtare të IOWA-s.
- Ministria e Mbrojtjes është pjesë e barabartë e Grupit të Kontaktit në Mbështetje të Ukrainës e udhëhequr nga SHBA-ja ku brenda 2022 janë realizuar 6 takime ku kanë marrë pjesë Ministri dhe Komandanti i FSK-së si dhe Koordinatorin nga Ministria jonë.
- Gjatë këtij viti është bërë bashkë-zbarkimi në Ishujt Falkland së bashku me ushtrinë e Mbretërisë së Bashkuar. Për këtë qëllim është nënshkruar Marrëveshja për Atashimin e Personelit të FSK-së në Kompaninë Roulment të këmbësorisë në ISHUJT FALKLAND.
- Dërgimi i Oficerit Ndërlidhës të FSK-së në LWC (Westminster), Britani e Madhe.
- Ministri dhe KOMFSK kanë marrë pjesë në ceremoninë e hapjes së ekspozitës vjetore të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara (The Association of the United States Army) – “AUSA 2022”.
- Koordinimi i pjesëmarrjes së Ministrit të Mbrojtjes në konferencën e Ministrave të Mbrojtjes të US-Adriatik Charter (A5), komandanti i FSK-së ka marrë pjesë në konferencën e Shefave të Mbrojtjes në kuadër të US-Adriatik Charter (A5), Drejtori i Politikave të Mbrojtjes ka marrë pjesë në mbledhjen e drejtorëve të Politikave të Mbrojtjes të iniciativës A5 ShBA – Karta e Adriatikut si dhe Rreshter majori i Parë i FSK-së ka marrë pjesë në konferencën e rreshter majorëve të parë në kuadër të A5- Karta e Adriatikut.





- Pjesëmarrja e Ministrit në takimin CEDC+Ministral në Austri, në kuadër të Iniciativës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes për Evropën Qendrore.
- Është realizuar takimi i Drejtorëve të Politikave të MM në kuadër të (Central European Defence Cooperation CEDC).
- Gjatë këtij viti është rishikuar dhe plotësuar rregulloren për Atashe të Mbrojtjes.
- Është nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me Maqedoninë e Veriut dhe me Malin e Zi. Me këto vende kemi pas MB të nënshkruar në vitin

2010, por është freskuar me ndryshimet e nevojshme.

- Vazhdon procesi i koordinimit për rishikimin e MB me shtetet partnere, me Holandën, Turqinë, Gjermaninë, Slloveninë, Hungarinë dhe Italinë. Këto MB janë në rishikim për arsye të ndërrimit të emrit dhe mandatit të Ministrisë (2018).
- Në Romë është realizuar takimin bilateral dhe me këtë rast është nënshkruar Planin Bilateral për vitin 2023. Takimi bilateral me Bundeswehri gjerman është zhvilluar gjithashtu në nëntor 2022 në Prishtinë, ku është bërë akordimi për aktivitet me Bundeswehri për vitin 2023.
- Janë realizuar takime bilaterale me Maqedoninë e Veriut dhe është nënshkruar plani bilateral për vitin 2023. Gjithashtu është zhvilluar takimin bilateral me Ministrinë e Mbrojtjes së Hungarisë dhe është bërë akordimi për planin bilateral 2023.
- Është organizuar konferenca vjetore FSK dhe Partnerët 2022, ku pjesëmarrës kanë qenë 28 delegacione nga shtete të ndryshme.



Përfaqësimi diplomatik


Gjatë këtij viti janë vendosur Atashetë e Mbrojtjes në Kroaci, Shqipëri dhe Mbretëri të Bashkuar. Si dhe është në proces të përzgjedhjes së Atasheut të Mbrojtjes për Mbretërinë e Holandës.

REALIZOHEN ME SUKSES AKTIVITETET E PARAPARA NË PLANIN VJETOR TË VEPRIMIT PËR MINISTRINË E MBROJTJES DHE NË KUADËR TË PLANIT TË PUNËS SË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Bazuar në Objektivat Strategjike Vjetore të Ministrit të Mbrojtjes për vitin 2022 dhe dokumenteve tjera relavante është koordinuar hartimi i Planit të Ministrisë së Mbrojtjes 2021-2023, ndërsa bazuar në programin qeveritar 2021-2025 të Qeverisë së Kosovës është hartuar edhe Plani i Punës për Qeverinë e Republikës së Kosovës (2021-2024) nga fushëveprimi i Ministrisë së Mbrojtjes.

DPV ka vlerësuar dhe raportuar progresin e bërë nga MM-ja për periudha të caktuara për nivelin e përmbushjes së objektivave të lidërshit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në mesin e aktiviteteve të DPV brenda 2022, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm dhe bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës ka përfaqësuar Ministrinë e Mbrojtjes në komisionin Qeveritarë për Persona të Zhdukur gjatë luftës në Kosovë, është dhënë kontribut në realizimin e misionit.



DEPARTAMENTI PËR TRANSFORMIM, MODERNIZIM DHE STANDARDIZIM

Departamenti i Transformimit, Modernizimit, Standardizimit dhe Programimit, ka monitoruar zbatimin e Planin Gjithëpërfshirës së Tranzicionit për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Gjatë vitit është përgatitur dhe i është dërguar lidërshipt Raporti Vjetor në Mbështetje të PGJT për vitin 2021 (A+3), si dhe raporti i tranzicionit për Fazën e Parë.

Plani Vjetor në Mbështetje të PGJT-së për vitin 2022 është përgatitur dhe është miratuar.

Bazuar në Planin Vjetor të Veprimit, është freskuar FOCIS-in me të dhënat e personelit dhe pajisjeve dhe për stafin e MM dhe FSK-së është mbajtur trajnimi për sistemin FOCIS.



Aktivitetet të cilat nuk kanë qenë të përfshira në Planin e Punës së DTMS-së

Pas rishikimit të TOPP 2020 dhe miratimit të TOPP 2022, është bërë krahasimi i ndryshimeve që kanë të bëjnë me PGJT, ku në këtë kontekst është përgatitur Raport Analizat për çështjet e personelit dhe pajisjeve, planin e blerjes së armatimit ndër vite 2022-2028, Koston Operative, Rezervat Operacionale dhe planifikimin e tyre.

DEPARTAMENTI PËR POLITIKAT E PERSONELIT DHE REKRUTIMIT

Në vitin 2022 është bërë shpallja e konkurseve për 23 pozita të nëpunësve civilë, prej të cilave në 10 pozita nëpunësit kane nënshkruar akt emërimi dhe 13 pozita janë anuluar.

Janë rekrutuar 5 nëpunës civil në FSK-së, ndërsa janë shpallur konkurset për 28 pozita tjera.

Nga 10 pozita të kategorisë së nëpunësve të shërbimit publik 6 pozita janë ri publikuar në mungesë të konkurrencës, ndërsa pozitat tjera janë në proces.



Rekrutimi i Kadetëve

Gjatë vitit 2022 janë rekrutuar 30 kadetë të FSK-së brenda dhe jashtë vendit:

QSU (22 kadetë) – të përzgjedhur 12 nga Republika e Kroacisë (2) – të përzgjedhur 1, Republika e Turqisë (8) – të përzgjedhur 5, Republika e Maqedonisë (1) – të përzgjedhur 1, Republika e Shqipërisë (5) – të përzgjedhur 5, Akademia e Forcave Ajrore dhe Forcave Detare/SHBA - nominohen 6 kandidatë.



Konkurset e brendshme: Kalimi nga grada e Nënoficerit në Oficer janë përzgjedhur 31 kandidatë dhe janë duke ndjekur kursin bazik për oficer (KVO) në Shkollën e Oficerëve; Akademia Mbretërore Sandhurst është përzgjedhur 1 kandidat dhe në Gjermani është në proces të përzgjedhjes.

Rekrutimi i Rekrutëve/Ushtarëve të Rinj

Aktiv: Për vitin 2023 janë planifikuar të rekrutohen 612 rekrut të rinj, 388 rekrut

rezervistë. Për vitin 2021-2022 ka qenë i paraparë për 840 pozita, ndërsa janë rekrutuar 819 ushtarë të FSK-së.

Konkursi për Atashe: Shpallja e konkursit të brendshëm për Atashe të FSK-së në të cilin kanë aplikuar për në Mbretërinë e Holandës janë dy kandidatë.

Në vitin 2022 është bërë hartimi Politikave të Personelit - Dokumenteve/Akteve dhe Pjesëmarrja në grupe punuese, është bërë hartimi i Rregullores për përkujdesjen e personelit të FSK-së para, gjatë dhe pas kthimit dhe përkujdesjen ndaj familjes së tyre gjatë misionit jashtë vendit dhe pjesëmarrja në hartimin e plotësimit ndryshimit të Rregullores për Atashetë e mbrojtjes.

Po ashtu, është bërë hartimi i Planit Vjetor Individual për Vitin 2023 për nëpunësit jo ushtarakë.

PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I BUXHETIT TE PAGAVE PËR TË GJITHA KATEGORITË E PERSONELIT PËR KASH-IN 2022-2024:

Ligji i Buxhetit për vitin 2022 mbi ndarjet buxhetore Nr.07/L-041buxhetit i miratuar ka qenë në shume prej 31,895,564.00 euro.

Në total, në tri nën programet nga buxheti i planifikuar prej 31,895,564.00 euro janë shpenzuar 29,123,210.40 euro apo 91.31% nga buxheti i përgjithshëm në paga dhe teprica e mjeteve ne tri programe është shuma 2,772,353.60 euro apo 8.69%.



Bashkëpunimi ndër Institucional: Përcjellja e listave të zyrtarëve të lartë si dhe njoftimi në Agjencinë Anti-korrupsion të Kosovës (AKK) për ndryshimin brenda afateve kohore të përcaktuara më ligj për Deklarimin e Pasurisë nga zyrtaret e lartë të cilët ushtrojnë detyrën të cilën ne bazë të ligjit janë të obliguar të bëjnë deklarimin e pasurisë.



APK

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E KARRIERËS DHE VERIFIKIMIT



Gjatë këtij viti në QSU janë shkolluar 61 kadetë, jashtë vendit janë shkolluar 45 kadetë, jashtë vendit janë realizuar 118 trajnime me 322 pjesëmarrës. Ndërsa në trajnime të brendshme kanë marrë pjesë 2011 pjesëtarë në 76 trajnime apo kurse të ndryshme, janë mbajtur 16 trajnime me 900 pjesëtarë etj.

Gjatë vitit 2022 janë larguar gjithsej 262 pjesëtarë të FSK-së, meshkuj 250 dhe 12 femra. Prej tyre 70 janë në pensionim të rregullt, : 70 pjesëtarë; Pensionim i parakohshëm: 5 pjesëtarë; Largim vullnetar (Demobilizim): 128 pjesëtarë; Shkarkim nga shërbimi: 5 pjesëtarë; Largim nga Bordi disiplinor: 52 pjesëtarë, (14 nga Komponenti Aktiv dhe 38 nga Komponenti Rezervë); Vdekje: 2 pjesëtarë -1 pjesëtar aktiv dhe një pjesëtar nga komponenti rezervë).

Proceset e emërimeve dhe gradimeve të bordeve, dhjetor 2021- dhjetor 2022:

Bordi për emërimet dhe gradimet OF3-OF5; Bordi OF1-OF3, përfshirë edhe pozitën e Rreshter Majorit të FSK-së; Bordi për emërimet dhe gradimet OR8-OR9; Bordi për emërimet dhe gradimet OR5-OR7; Bordi për emërimet dhe gradimet OR2-OR4.

Menaxhimi i Procesit të Verifikimit në MM/FSK:



- Për të kaluar procedurat e verifikimit në AKI janë kontrolluar dhe pranuar për cilësi dyqind 265 pyetësorë të sigurisë të dorëzuar në Sektorin e Koordinimit të Verifikimit nga zyrtaret/pjesëtarët e MM/FSK-së.
- Është ndërprera procedura e verifikimit në AKI, për pesë zyrtarë/pjesëtarë të MM/FSK pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës.
- Ndërsa janë pranuar nga AKI/DVS rezultate pozitive të verifikimit për 268 zyrtarë/pjesëtar të MM/FSK-së.
- Në vitin 2022 janë përfunduar procedurat e Pastërtisë së Figurës për 847 kandidatë për rekrutë të FSK, ku 36 prej tyre nuk e kanë kaluar Pastërtinë e Figurës.

DEPARTAMENTI PËR LOGJISTIKË DHE INFRASTRUKTURË

Gjatë vitit 2022 Departamenti i Logjistikës dhe Infrastrukturës ka qenë i angazhuar në hartimin e këtyre dokumenteve logjistike:

Rishikimin e udhëzuesit për dërgimin e personelit dhe pajisjeve jashtë vendit;

Përfundimin e draftit final të udhëzuesit mirëpo duhet pritur që ky udhëzues të miratohet paraprakisht nga MF;

Rishikimin e udhëzuesit për investime dhe mirëmbajtje themelore të objekteve në FSK dhe gjithashtu ka përfunduar udhëzuesin për mbështetjen e vendit pritës dhe është hartuar plani i veprimit nga Departamenti për Logjistikë dhe Infrastrukturë për vitin 2022.

Ka përfunduar KASH-i (është përfunduar lista e prioriteteve projekteve kapitale për vitin 2023-2025) dhe është punuar në planin e buxhetit (pjesa e logjistikës) për vitin 2023, si dhe është punuar në draft planin e Prokurimit për vitin 2023.



DONACIONET SI TREGUES I FUQISHËM I PËRKUSHTIMIT TË SHTETEVE MIKE



MM dhe FSK gjatë vitit 2022 kanë pranuar donacione të llojeve të ndryshme nga vende të ndryshme si nga Turqia, SHBA-ja, Mbretëria e Bashkuar etj.

Në kuadër të donacioneve, MM dhe FSK ndër të tjera nga qeveria gjermane ka pranuar nga donacionin për FSK-në në vlerë prej 405 mijë euro, Ministria turke e Mbrojtjes dhuroi një kontingjent të uniformës ushtarake të kamuflimit në borë për FSK-në, nga EULEX ka pranuar katër automjete, etj.

Spektori për Infrastrukturrë dhe Mirëmbajtje ka dizajnuar gjithsejtë 15 projekte kapitale në Infrastrukturrë

Nga gjithsej 20 projekte/kontrata të planifikuara për realizim në vitin 2022, 9 projekte/kontrata kanë përfunduar ndërsa 11 projekte tjera janë në faza të ndryshme të realizimit sipas planeve dinamike kontraktuale dhe vazhdojnë edhe në vitin 2023.

Buxheti i planifikuar për projekte kapitale në Infrastrukturrë për vitin 2022 ishte: 6,225,170.81 €.

Spektori për Furnizim dhe Transport

Spektori i Furnizimit, Transportit dhe Mirëmbajtjes gjatë kësaj periudhe ka realizuar përmbushjen e detyrave të planifikuara për vitin 2022 si në vijim:

Pranimi dhe analizimi i kërkesave të pranura nga Administratat MM dhe nga SHPFPSK, si dhe procedimi i tyre për zotim dhe prokurim;

Kërkesat e përbashkëta të MM – së dhe FSK – së, dhe sipas Planit të Prokurimit është bërë analiza dhe inkorporimi në një kërkesë të përbashkët si dhe procedimi i tyre i mëtutjeshëm;

Azhurnimi i të dhënave dhe raportimi i progresit fizik të realizimit të projekteve kapitale në programin qeveritar - Programin për Investime Publike (P.I.P).

Janë iniciuar kërkesat për zotimin e mjeteve financiare dhe disponueshmerin e fondeve për 16 Projekte.

Sipas planit të Prokurimit 2022 janë iniciuar dhe ri iniciuar 103 kërkesa për kategorinë për Furnizime, ndërsa në kategorinë Shërbime janë iniciuar dhe ri iniciuar 47 kërkesa për prokurim.

Spektori për Analiza të Blerjeve Ushtarake

Gjatë vitit 2022 Spektori për Analiza të Blerjeve Ushtarake ka pranuar tri lista, me projekte të veçanta ku 16 projekte janë në listën e parë sipas vendimit të Ministrit, lista e dytë me projekte të veçanta ka 7 projekte dhe lista e tretë, me projekte të veçanta me 2 projekte.

DEPARTAMENTI PËR KOMUNIKIM DHE TEKNOLOGJI INFORMATIVE



Në vitin 2022 është bërë plotësim-ndryshimit të Strategjisë për siguri kibernetike në MM/FSK dhe hartimi i Planit të veprimit 2022-2024.

Strategjia për mbrojtje kibernetike në MM/FSK, do të përfundohet pas aprovimit të Strategjisë shtetërore për siguri kibernetike.

Projekti i modernizimit të sistemit të TI-së dhe sigurisë kibernetike



Në kuadër të projektit të modernizimit të sistemit të TI-së dhe sigurisë kibernetike është punuar në dy drejtime. Në një drejtim janë marrë këshilla për hartimin e Legjislacionit, Politikave dhe Strategjisë për siguri kibernetike si dhe format e organizmit dhe bashkëpunimit me institucionet relevante të sigurisë në RKS kurse në anën tjetër është punuar në dizajnimin dhe implementimin e sistemit bazuar në planin e modernizimit të sistemit.

Auditimi i sistemit të TI-së

Është realizuar auditimi për implementimin e Politikave të sigurisë në sistemin e TI-së në NJK dhe NJMK. Njëkohësisht është hartuar edhe raporti për të gjeturat dhe rekomandimet.

Koordinimi dhe menaxhimi i implementimit të marrëveshjeve me Operatorët Ekonomik (OE) të cilët ofrojnë shërbime të telefonisë fikse, mobile, IPTV dhe FO në MM/FSK.

Pjesëmarrja dhe angazhimi në kuadër të Këshillit Shtetëror për Siguri Kibernetike në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e sigurisë kibernetike në vend dhe përcjellja e implementimit të planit të veprimit për Strategjinë Shtetërore për Siguri Kibernetike për aktivitetet që MMFSK është përgjegjëse për implementim.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit

Sipas vendimit të Ministrit të Mbrojtjes për emërimin e Komisionit të përbashkët MM/FSK për rishikimin e “Sistemit të Menaxhimit të Informacionit” të udhëhequr nga Drejtori i DKTI-së, është rishikuar dhe finalizuar Projekti me të gjitha kërkesat e njësive kërkuuese si dhe kërkesat administrative dhe teknike.

Dokumentimi i rrjeteve dhe pajisjeve të TI-së dhe komunikimit në MM

Projekti ka përfunduar sipas planit, ku është bërë evidentimi i rrjeteve dhe pajisjeve të komunikimit.

Mirëmbajtja e rrjeteve dhe pajisjeve të TI-së

Me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në MM, është realizuar mirëmbajtja e pajisjeve dhe rrjetit të TI-së sipas nevojës dhe kërkesave të përdoruesve të pajisjeve të TI-së.

Vetëdijesimi i përdoruesve të MM/FSK për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike

DKTI ka përgatitur në vazhdimësi materiale të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për rreziqet në fushën e sigurisë kibernetike.

Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme jashtë planit

Në kuadër të GP lidhur me Marrëveshjen për shkëmbim të informacionit në mes të Kosovës dhe SHBA, janë prezantuar hapësirat dhe format e ruajtjes së informacionit në sistemin e TI-së në takimet e përbashkëta virtuale si dhe gjatë vizitës së ekspertëve nga SHBA për vlerësimin e sigurisë së informacionit të klasifikuar.

KAPACITETET MJEKËSORE NË FSK AVNACOHEN NË BASHKËPUNIM TË NGUSHTË ME INSTITUCIONET VENDORE



Gjatë viti 2022 Departamenti i Mjekësisë ka përfunduar hartimin e dokumentit “Politika mjekësore në MM/ FSK, Doktrinën mjekësore në MM/FSK dhe ka përfunduar “Konceptin Shëndetit Mental dhe Mirëqenia në MM/FSK” .

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet vendore në fushën e mjekësisë, gjatë vitit 2022 ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet vendore në fushën e mjekësisë si: Ministrinë e Shëndetësisë, SHSKUK-ën, Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, Agjensionin e Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Gjatë këtij viti në kuadër të bashkëpunimit bilateral dhe me partnerët janë realizuar aktivitete me Gardën e Ajrovës, Ushtrinë Turke, Ushtrinë Italiane, Ushtrinë Shqiptare, Qendrën e Ekselencës së NATO-s në Hungari.



DEPARTAMENTI I MBËSHTETJES

Në kuadër të këtyre detyrave që ka realizuar Departamenti i Mbështetjes konform planit të veprimit për vitin 2022 janë: analizimi dhe vlerësimin i specifikacionit teknik dhe inicimi i kërkesave për procedura të prokurimit për furnizime me mallra dhe shërbime për nevojat e MM-së, procedimi i kërkesave për furnizime me mallra dhe shërbime për nevojat e MM-së sipas Planit të prokurimit dhe Planit buxhetor; Menaxhimi i mbështetjes së MM-së me shërbime të mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të materialeve elektrike, hidro-sanitare, klimatizimit, ventillimit, nxemjeve, inventarit dhe pajisjeve tjera, servisimin e automjeteve të MM-së etj.

Gjithashtu është bërë hartimi i Planit të Prokurimit në fushëveprimin e mbështetjes për vitin 2022 në bashkëpunim me DLI.

DEPARTAMENTI I GRUMBULLIMIT DHE ANALIZËS (DGA)

Gjatë kësaj periudhe ka vazhduar mbledhja e informacioneve, përpunimi, analizimi dhe përgatitja e produkteve të inteligjencës për lidhshirësin e MM-së dhe FSK-së në mbështetje të vendimmarrjes së tyre .

DGA, ka vazhduar bashkëpunimin dhe aktivitetet bilaterale me strukturat e inteligjencës dhe sigurisë në vend si Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Policinë e Kosovës (PK), KFOR-in, si dhe me SHBA-në dhe strukturat homologe të partnerëve rajonal.

DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE SIGURI (DPSIG)

Në kuadër të hartimit, plotësimit të politikave dhe dokumenteve strategjike sipas planifikimit (TM1-TM4), gjatë këtij viti janë hartuar/plotësuar dhe miratuar tre udhëzues, kurse, nuk janë miratuar dy udhëzues.

Vlenë të përmendet nënshkrimi i kontratës dhe fillimi i implementimit të projektit 2022-2024 “Modernizimi dhe Mirëmbajtja e Sistemit të Sigurisë në MM”.

Sa i përket koordinimit ndër-institucional me përfaqësuesit të SHBA-ve lidhur me marrëveshjen gjenerale për sigurinë fizike të informacionit të klasifikuar(GSOIA) duhet të ceket se është finalizuar draft-marrëveshja në fjalë dhe në kuadër të këtij procesi është realizuar vizita së partnerëve amerikan (NDPC) në Kosovë.

Gjatë vitit 2022 është bërë koordinimi i punëve me Policinë Ushtarake, marrja e masave të sigurisë rreth vizitave të ndryshme, çështjeve tjera të sigurisë në MM, angazhim në rregullimin e kartelave për personelin e MM/FSK dhe personelin ndërkombëtar në MM dhe përgatitja e raporteve të rregullta.

DEPARTAMENTI PËR MENAXHIMIN E FINANCIVE

Departamenti për Menaxhimin e Financave mbi bazën e objektivave të parapara në planin e veprimtimit për vitin 2022 i ka realizuar këto aktivitete: Përgatitja e planeve buxhetore, Ndryshimet e buxhetit në vitin 2022, Mbajtja e evidencës së shpenzimeve dhe raportimi, Menaxhimi i pasurisë jo financiare, Sigurimi i funksionit të kontrollit të brendshëm.

Buxheti i aprovuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2022

Sipas Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes është **102,305,450.00** euro, i ndarë sipas kategorive ekonomike si në tabelën në vijim:

Shpenzime operationale në vlerë **47,009,450 Euro** apo **46%** dhe
Shpenzime Kapitale në vlerë **55,296,000 Euro** apo **54%**.


QENDRA NDËRKOMBËTARE E TRAJNIMIT PËR KËRKIM-SHPËTIM E FSK-SË


Përkundër sfidave, QNTKSH në vitin 2022 realizoi 53 trajnime me 1845 pjesëmarrës në trajnime, prej të cilëve 1200 ishin nga institucionet tjera vendore dhe vendet partnere.

Ky sukses i jashtëzakonshëm u arrit falë përkushtimit dhe angazhimit të stafit profesional të saj të cilëve u shprehi mirënjohjen e lartë.

Vlerësimet aktuale të instancave dhe organizatave kredibile ndërkombëtare të fushës së kërkim-shpëtimit konfirmojnë se Qendra jonë disponon strukturën më të mirë të trajnimit për KSH në Evropë.

Synimi yni kryesor për vitin 2023 është krijimi i një qendre trajnime me më shumë personel të specializuar dhe objekte trajnime për kërkim—shpëtim.





MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTARSTVO ODBRANE
MINISTRY OF DEFENSE